



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

---

Numri i lëndës: 2019:266872

Datë: 07.08.2020

Numri i dokumentit: 01053445

**P.nr.1048/19**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE – Departamenti i Përgjithshëm në Pejë**, sipas gjyqtarit Murat Hulaj, me praktikante gjyqësore Edita Ferati, në lëndën penale kundër të pandehurit E.L nga Peja, me vendbanim ne ...për vepër penale Heqja apo demtimi i vulave zyrtare ose i shenjave parashikuar nga neni 406 i KPRK-se, sipas aktakuzës PP/II nr. 1807/2019 të dt.15.11.2019, duke vendosur lidhur me kërkesën për dhënien e urdhrit ndëshkimor të Prokurorisë Themelore në Pejë të dt.06.07.2020, me dt.07.08.2020 merr këtë:

**A K T G J Y K I M**

**PRANOHET** kërkesa e Prokurorisë Themelore në Pejë sipas aktakuzës PP/II nr. 1807/2019 të dt.15.11.2019, e dt.06.07.2020, dhe kjo gjykatë pa mbajtur shqyrtimin gjyqësor merr:

**URDHËR NDËSHKIMOR.**

**Ndaj të pandehurit**

E L, i lindur me date...ne Peje, me vendbanim ne..nga i ati B, nga e ëma N, e vajzërisë D, i martuar, i gjendjes se mesme ekonomike, me profesion Vozitës, i identifikuar ne baze te letërnjoftimit me numër personal ..., posedon numër te telefonit ..., i nacionalitetit Shqiptar, Shtetas i Republikës se Kosovës, gjendet ne liri,

**ËSHTË FAJTOR**

**Për arsye se:**

- Me datën 12.07.2019 rreth ores 11:55, ne rrugën..., përkatësisht pranë firmës "B..", me qellim hape objektin e siguruar ne atë mënyrë qe në ditën kritike ne adresën e lartcekur inspektoret komunal kane ndaluar dy kamionë te firmës "B" SHPK ne

pronësi të të pandehurit te cilat ishin duke zhvilluar punën edhe përkundër faktit se me datën 23.05.2019 inspektorët komunal i kishin vendosur shiritin duke i ndaluar punën te njëjtë.

-me çka ka kryer veprën penale, *Heqja apo demtimi i vulave zyrtare ose i shenjave* parashikuar nga neni 406 i KPRK-se.

Andaj gjykata konform nenit 34,36, 39, 64 par. 1 dhe neni 406 të KPRK-së të pandehurit i shqipton:

### DËNIM ME GJOBË

-Ashtu që ia përcakton dënimin me gjobë në lartësi prej 200 €, e të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në afat prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të aktgjykimit.

-Nëse i pandehuri dënimin në fjalë nuk e paguan në afatin e përcaktuar, dënim me gjobë do ti zëvendësohet me dënim burgu, duke llogaritur një ditë burgu 20 euro.

-I pandehuri obligohet që në emër të paushallit gjyqësor dhe shpenzimeve procedurale të paguaj shumën prej 30 (tridhjetë) euro, si dhe në emër të kompensimit të viktimave shumën prej 30 (tridhjetë) euro, e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pasi që aktgjykimi të marrë formën e prerë.

### A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë, ka ngritë aktakuzë PP/II nr. 1807/2019 të dt.15.11.2019, ndaj të pandehurit E L nga Peja, me vendbanim ne rr... për veprën penale, *Heqja apo demtimi i vulave zyrtare ose i shenjave* parashikuar nga neni 406 i KPRK-se.

Prokuroria Themelore në Pejë pas ngritjes së aktakuzës, me dt.06.07.2020 gjykatës i ka dërguar kërkesën për dhënien e urdhrit ndëshkimor me të cilin të pandehurit do i shqiptohet dënim me gjobë.

Gjykata me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes konform neni 495 të KPRK gjeti se janë plotësuar kushtet nga dispozita e neni 493 të KPRK dhe pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor vendosi që ta pranoi kërkesën e Prokurorisë Themelore në Pejë, për dhënien e urdhrit ndëshkimor dhe të shqiptoi ndaj të pandehurit dënimin me gjobë si në dispozitiv të aktgjykimit.

Kjo gjykatë konsideron se provat e bashkangjitura shkresave të lëndës janë prova të besueshme mbi bazën e të cilave vërtetohet se i pandehuri është kryesi i veprës penale për të cilën akuzohet.

Me rastin e shqyrtimit të dënimin gjykata e vlerësoi të gjitha rrethanat të cilat konform neni 64 të KPK ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimin, me ç rast si rrethana lehtësuese gjykata vlerësoi të dhënë se i pandehuri më parë nuk ka qenë i dënuar dhe ndaj tij nuk zhvillohet ndonjë procedurë tjetër penale.

Rrethana rënduese për të pandehurin për momentin nuk ka gjetur, prandaj, gjykata të pandehurin e dënoi si në dispozitiv të Urdhrit ndëshkimor duke e bindur se ky dënim është adekuat me shkallën dhe rrezikshmërinë e veprës penale por edhe me shkallën e përgjegjësisë penale duke qenë e bindur se edhe me këtë dënim, ndaj tij mund të arrihet qëllimi i dënimin i paraparë me neni 34 të KPK.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është bazuar në nenin 450 të KPPK-së, ndërsa kompensimi për viktimat e krimit u morr Konform nenit 39 par.1,2,3 nën par. 3.1 të Ligjit për Kompensim të Viktimave të Krimit

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 493, 495 të KPPK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË,  
Departamenti i Përgjithshëm  
P.nr.1048/19 me dt.07.08.2020**

Praktikante gjyqësore  
Edita Ferati

G j y q t a r i,  
Dr.sc. Murat Hulaj

**UDHËZIM JURIDIK:**

Kundër këtij aktgjykimi i pandehuri  
Ka të drejtë të ushtrojë kundërshtim  
në afat prej 8 ditësh, të njëjtës gjykatë.